



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1364/10 prot.,

Datë 04.06.2026

V E N D I M
Nr. 753/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.06.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 673/2026, datë 20.05.2026 në procedurën e prokurimit “E Hapur, Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24(njëzet e katër) mujor”, me Nr. REF-79117-03-12-2026, me objekt: “Blerje vegla dhe aksesorë ndihmës”, me fond limit 12,823,875 (dymbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 09.04.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.

Ankimues: Operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me Nipt M113130290 dhe adresë: Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi rezidencial “Magnet” Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik Rruga “5 Maji” , Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të

Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 20.05.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 673/2026, ku vendosi:

[.....]

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK, në procedurën e prokurimit “E Hapur, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24 (njëzet e katër) mujor”, me Nr. REF-79117-03-12-2026, me objekt: “Blerje vegla dhe aksesore ndihmës”, me fond limit 12,823,875 (dymbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 09.04.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK, duke e kualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë” [...]

I.2. Me shkresën nr. 933/21 prot., datë 29.05.2026, protokolluar me tonën nr.1364/7 prot., datë 03.06.2026, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 673/2026 datë 20.05.2026 duke i bashkëlidhur shkresës dhe procesverbalin e rivlerësimit të procedurës objekt ankimi.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 933/21 prot., datë 29.05.2026, protokolluar me tonën nr.1364/7 prot., datë 03.06.2026, autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 673/2026 datë 20.05.2026 duke i bashkëlidhur shkresës dhe procesverbalin e rivlerësimit të procedurës objekt ankimi.

II.2. Referuar shkresës së mësipërme dhe verifikimit të raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP Nr. 673/2026, datë 20.05.2026.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “E Hapur, Marrëveshje kuadër me një operatorë ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara, me afat 24(njëzet e katër) mujor”, me Nr. REF-79117-03-12-2026, me objekt: “Blerje vegla dhe aksesore ndihmës”, me fond limit 12,823,875 (dymbëdhjetë milion e tetëqind e njëzet e tre mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 09.04.2026, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Tiranë.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro